

**RELACION**

**PËR PROJEKTLIGJIN PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.**

Projektligji “Për faturën dhe sistemin e Monitorimit të qarkullimit” mbështet në nenet 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës.

Projektligji i propozuar ka për synim krijimin e një sistemi të ri faturimi dhe monitorimi të transaksioneve të bizneseve në vend, bazuar në një sistem të ri të pajisjeve fiskale (*gjenerata e re e kasave fiskale*).

Reforma e Fiskalizimit është një angazhim madhor i Qeverisë në përpjekjen e saj për të minimizuar ekonominë informale përmes modernizimit të sistemit të monitorimit të taksave. Ky projektligj synon:

- *Minimizimin (uljen) e niveli të ekonomisë informale;*
- *Përmirësimin e mbledhjeve të të ardhurave;*
- *Identifikimin më lehtë të evazionit;*
- *Bërjen e auditimit të taksave më kost-efiçent;*
- *Uljen e nivelit të korrupsionit në administratë;*
- *Ofrimin e më shumë shërbimeve publike për qytetarët dhe biznesin;*
- *Pozicionimin e Shqipërisë më afër standardeve të Bashkimit Evropian.*

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të luftojë evazionin fiskal nëpërmjet një legjislacioni të shëndetshëm, pajisjeve teknologjike dhe informacionit të përfituar në kohë reale për çdo transaksion të kryer në vend.

Administrata Tatimore do të ketë në dispozicion të dhëna të sakta dhe në kohë reale të cilat do të shërbejnë për një proces sa më të mirë planifikimi, menaxhimi, vlerësimi dhe vendimmarrës me qëllim mireadministrimin tatimor.

Kjo zgjidhje ligjore e re kontribuon në përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, mbledhjen e tatimeve dhe krijimin e një mjedisstimulues për biznesin.

Projektligji perfshin edhe organet publike të cilat përcaktojnë procedura të tjera (për shembull: monitorimi i afateve të pagesës, përcaktimi i procedurës që mundëson kryerjen e pagesave më shpejtë, përcaktimi i masave për zbatim më të shpejtë të procedurës së falimentimit, evitimi i mbingarkesës me borxhe, monitorimi i transparencës persa i perket faturimit në procedurat e prokurimit publik, në mënyrë që të rrisë efikasitetin, ulë korrupsionin dhe pengesat administrative, etj.).

Prandaj, është e rëndësishme të konsiderohet se futja e zgjidhjeve ligjore të reja sjell një numër efektesh të tërthorta pozitive:

- nxit zhvillimin e softwerit dhe mbështetjes në fushën e teknologjisë së informacionit,
- promovon konkurrencën e tregut,
- zhvillon bërjen biznes në mënyrë elektronike,
- nxit informatizimin e shoqërisë në tërësi, dhe
- mundëson që tatimpaguesit të krijojnë një sistem eficient të kontrollit të brendshëm të punës dhe të punonjësve të tyre.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2019 si pjesë e paketës fiskale.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Ngritja e ndërgjegjësimit mbi nevojën për të paguar tatimet dhe besimi i qytetarëve për drejtësi në sistemin tatimor, është një problem për të gjitha ekonomite bashkëkohore.

Një shoqëri bashkëkohore me ekonomi në rritje, ka nevojë për një kuadër të qëndrueshëm ligjor për zhvillim të mëtejshëm. Kjo nënkupton që legjislacioni aktual, i kushtëzuar nga zhvillimi teknologjik, duhet të jetë gjithmonë në hap me ndryshimet në shoqëri dhe ekonomi.

Tatimet zbatohen për të mbuluar shpenzimet kryesore të shtetit dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Të ardhurat e mbledhura shërbejnë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e shërbimeve publike. Mbledhja e shumës së saktë të tatimit në përputhje me ligjin është gjithmonë me rëndësi të madhe. Me qëllim që të mbrohen të drejtat e qytetarëve dhe të ruhen përfitimet dhe shërbimet që qytetarët presin nga shoqëria, është me rëndësi që tatimet të mbliidhen në mënyrë të plotë dhe në kohë, dhe që mashtrimi tatimor, evazioni fiskal dhe shmangia e tatimeve të parandalohen dhe luftohen. Kjo gjithashtu është çështje e drejtësisë e cila mundëson që tatimpaguesit e ndershëm të mos ngarkohen me tatime shtesë për shkak se tatimpaguesit e tjerë nuk i përmbushin detyrimet e tyre dhe nuk paguajnë tatimet. Për të siguruar këtë, është me rëndësi të madhe të ngrihet efikasiteti dhe efektiviteti i menaxhimit të mbledhjes së tatimeve.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është të krijojë një regjistër të subjekteve që lëshojnë fatura, të kontrollojë përmbajtjen e tyre dhe të monitorojë të gjitha faturat e lëshuara (pavarësisht nëse ato paguhen menjëherë, me para në dorë, ose më pas pa para në dorë) gjatë kryerjes së transaksioneve B2C (*Business to Consumer*), B2B (*Business to Business*) dhe B2G (*Business to Government*), si dhe të monitorojë pagesat e faturave të lëshuara dhe të regjistruara pa para në dorë, në kohë reale, nga administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë. Ligji i ri parashikon detyrimin e aplikimit të faturës elektronike dhe regjistrimin e pagesave të faturave pa para në dorë, si një fushë e re dhe deri më tani e parregulluar.

Ky ligj rregullon këto çështje themelore: detyrimin për të lëshuar faturë në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, subjektet e lëshimit të faturës, përmbajtjen e faturës, procedurën e lëshimit të faturës, detyrimin për të aplikuar faturën elektronike në transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe në procedurat e lidhura me organet publike, zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturës, regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësit e softuerve për lëshimin e faturave, procedurën për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike të lëshuara, detyrimin për të lëshuar faturë shoqëruese dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit e faturës shoqëruese dhe dispozita të tjera thelbësore për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji.

Kjo zgjidhje ligjore mundëson transparencë te transaksioneve, rritje te formalizimit te tyre, ulje të evazionit fiskal, si dhe kontribuon në ngritjen e ndërgjegjësimit për të paguar tatimet nëpërmjet të dhënave specifike të siguruara nga administrata tatimore, ndër të tjera, edhe me qëllim parandalimin e pastrimit të parave. Administrata tatimore do të ketë informacion dhe pasqyrim për secilën faturë të lëshuar dhe të paguar me para në dorë ose në mënyra tjera, në kohë reale, nëpërmjet një lidhjeje interneti me tatimpaguesin, institucionet financiare ose ndërmjetësit financiarë.

Zbatimi i lëshimit të faturave në mënyrë elektronike për biznesin, nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha përparësive që teknologjia mundëson, përshpejton dhe automatizon proceset e punës, ul kostot e biznesit, realizon kursime të konsiderueshme dhe potencialisht krijon një vlerë të shtuar në veprimtarinë e biznesit, si dhe në administratën shtetërore. Përveç kësaj, harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e Këshillit 2014/55/KE, është i rëndësishëm për arsye të nevojës për të reduktuar dhe eliminuar pengesat në tregtinë ndërkufitare në Bashkimin Evropian.

Në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, aktualisht është duke u përdorur një standard i përbashkët evropian i Komitetit Evropian për Standardizim (CEN), datë 28.06.2017, EN 16931-1: 2017, Fatura Elektronike, për modelin e të dhënave semantike të elementeve bazë të faturës elektronike (“standardi evropian për lëshimin e faturave elektronike”), më tej referuar si “*Standard evropian*”. Në këtë standard, i cili nga ana e teknologjisë është neutral, janë përcaktuar elementet bazë të cilat fatura elektronike duhet gjithmonë të përmbajë, duke lehtësuar kështu dërgimin dhe marrjen e faturave elektronike ndërmjet sistemeve të bazuara në standarde të ndryshme teknike, me qëllim të heqjes ose reduktimit të pengesave për tregtinë dhe për ngritjen e sigurisë ligjore.

Ne kete menyre sigurohet ndërveprimi dhe përpunimi i informacionit të paraqitur në mënyrë konsistente ndërmjet sistemeve të biznesit, pavarësisht teknologjisë, aplikimit ose platformës.

Standardi evropian për faturën elektronike është i përshtatshëm për përdorim në transaksionet tregtare ndërmjet subjekteve private ekonomike, duke përfshirë NVM-të dhe për përdorim në fushën e prokurimit publik.

Përfitimet nga lëshimi i faturave elektronike janë më të mëdha nëse krijimi, dërgimi, transferimi, marrja dhe përpunimi i faturës, kryhet plotësisht në mënyrë automatike. Prandaj, faturat e leshura, që mund të lexohen nga makina kompjuterike dhe të cilat marrësi mund të përpunojnë automatikisht dhe në mënyrë digjitale, konsiderohen në përputhje me standardin evropiane për lëshimin e faturave elektronike.

Shkëmbimi i e-Faturave mundëson lidhjen e bizneseve dhe lidhjen e enteve publike, që si synim përfundimtar, çon në një konkurrencë më të ndershme të të gjithë pjesëmarrësve në treg.

Përveç kësaj, përdorimi i e-Faturës u mundëson autoriteteve përkatëse tatimore, kryerje më të thjeshtuar të detyrave të kontrollit tatimor.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Propozimi i projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” është mbështetur në nenet 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVË).**

Ky ligj, dhe në veçanti dispozitat për e-Faturën, në rendin juridik të Republikës së Shqipërisë, transponon Direktivën 2014/55/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.04.2014, për lëshimin elektronik të faturave në prokurimin publik dhe Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28.11.2006, për një sistem të përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar (OJL 347, 11.12.2006), në lidhje me faturën elektronike.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT.**

Projektligji përbëhet nga 49 nene:

Në **nenin 1**, përcaktohet objekti i këtij ligji.

Në **nenin 2**, përcaktohet fusha e veprimit dhe subjektet që duhet zbatuar këtë ligj.

Në **nenin 3**, Në këtë nen përcaktohen termat të cilët do të përdoren në ligj, si dhe përkufizimet perkatëse;

Në **nenin 4**, përcaktohen subjektet që lëshojnë fatura. Dispozitat e ligjit nr. 9920 për procedurat tatimore janë transferuar në këtë ligj, ndërsa janë shfuqizuar në ato ligje, me qëllim që të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me lëshimin e faturave të jenë të përcaktuara në një vend të vetëm, për të lehtësuar zbatimin, aplikimin dhe mbikëqyrjen e këtij ligji.

Në **nenin 5**, përcaktohen disa përjashtime nga detyrimi për të lëshuar faturën, te tille si prodhuesit bujqësorë, që operojnë sipas skemës së kompensimit të fermerit në përputhje me ligjin për TVSH-në; shitja e biletave dhe kuponave nga shoferi i mjetit të transportit në linjat e transportit urban, në përputhje me vendimet e njësisive të vetëqeverisjes vendore; furnizimi i mallrave dhe shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si “ambulante”; individët në rastet kur japin me qira një ambient;

Në **nenin 6**, përcaktohen rregullat e përgjithshme për lëshimin e faturave. Si rregull, faturat duhet të lëshohen për çdo furnizim të mallrave dhe shërbimeve në çdo veprimtari ekonomike,

sipas përcaktimeve në ligjin për TVSH-në. Detyrimet në këtë nen janë marrë nga ligjipër TVSH-në dhe janë përafuar me Direktivën për TVSH-në.

**Në nenin 7,** përcaktohen rastet e veçanta për tatimpaguesit e caktuar që duhet lëshuar fatura.

**Në nenin 8,** përcaktohet momenti i lëshimit të faturave dhe te e-Faturës. Koha e faturimit është në përputhje me dispozitat aktuale të ligjit për TVSH-se.

**Në nenin 9,** përcaktohen të dhënat e detyrueshme që secila faturë duhet të përmbajë, përveç atyre faturave që lëshohen me procedurë të thjeshtuar.

Shumica prej këtyre të dhënave do të mund të programohen dhe memorizohet në zgjidhjen softuerike, pra të përcaktohen në mënyrë automatikisht sipas rregullave të përcaktuara dhe nuk do të ketë nevojë të futen manualisht nga operatori ose të rishkruhen çdo herë,

**Në nenin 10,** Në këtë nen përcaktohet përmbajtja e detyrueshme e e-Faturës në transaksionet ndërmjet bizneseve private, duke përfshirë bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe për transaksionet me organet publike.

**Në nenin 11,** përcaktohet përjashtimi nga nenet 9 për faturat që duhet lëshuar me procedurën e thjeshtë (më me pak të dhëna në faturë), në mënyrë që të ulet barra administrative për tatimpaguesit që i nënshtrohen regjimit të bizneseve të vogla

**Në nenin 12,** përcaktohet mënyra e krijimit të numrit të faturës, i cili duhet të ndjekë një renditje numerike, që do të përcaktohet në detaje me udhëzim.

**Në nenin 13,** përcaktohet detyrimi i regjistrimit i subjekteve që lëshojnë fatura. Administrata Tatimore do të mbajë një regjistër të të gjithë tatimpaguesve që lëshojnë fatura, në kuadër të regjistrimit të tatimpaguesve, që do të jetë pjesë e sistemit të “self-care”.

**Në nenin 14,** përcaktohet detyrimin për të regjistruar vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nëpërmjet platformës qendrore të faturave. Vetëm në raste të veçanta, nëse tatimpaguesi ndodhet në një zonë ku nuk ka lidhje interneti, atëherë regjistrimi kryhet në drejtorinë përkatëse të Administratës Tatimore.

**Në nenin 15,** përcaktohet detyrimi për të regjistruar operatorin. Kjo nënkupton regjistrimin e një individi ose personi fizik i cili do të autorizohet nga tatimpaguesi për të lëshuar fatura. Një operator mund të punojë në disa kasa, në mjedise të ndryshme të biznesit, dhe kjo nuk do të kufizohet nga ky sistem. Por, sistemi do të mund të monitorojë rastet e mosdeklarimit të punonjësve.

**Në nenin 16,** përcaktohen dy lloje detyrimesh: 1.detyrimi i prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit të zgjidhjes softuerike për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, i cili duhet të regjistrohet në një regjistër të veçantë të prodhuesve dhe/ose mirëmbajtësve të zgjidhjes softuerike, si dhe të regjistrimin e zgjidhjes së tij softuerike,të cilat do të certifikohen dhe kontrollohen nga AKSHI nëse është në përputhje me specifikimet teknike të këtij ligji dhe 2. detyrimi i çdo subjekti që lëshon fatura për të regjistruar mirëmbajtësin e zgjidhjes softuerike.

**Në nenin 17,** përcaktohet regjistrimi i të gjitha faturave të blerjes dhe shitjes në librat përkatës, të cilët, sipas ligjit aktual duhej të paraqiteshin çdo muaj,së bashku me deklaratën mujore të TVSH-së. Librat mund të përdoren edhe për të plotësuar regjistrimin për TVSH, kështu që

deklarata e TVSH-së do të jetë e mbushur me të dhënat që aktualisht janë marrë nga libri i shitjes dhe blerjes.

**Në nenin 18,** përcaktohet procedura për zbatimin e fiskalizimit të faturave të lëshuara.

**Në nenin 19,** përcaktohet detyrimi për të gjithë subjektet që lëshojnë fatura që të pajisen me një certifikatë elektronike nga AKSHI. Certifikata e njëjtë do të mund të përdoret për autentifikimin zgjidhjes softuerike për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave mesistemin e Administratës Tatimore. Pastaj për nënshkrimin elektronik të mesazheve që dërgohen në Administratën Tatimore, së bashku me përmbajtjen e elemente të faturës.

**Në nenin 20,** përcaktohet detyrimi për të nënshkruar në mënyrë elektronike çdo faturë që dërgohet në Administratën Tatimore nëpërmjet lidhjes së internetit, për verifikim.

**Në nenin 21,** përcaktohet detyrimi për të fiskalizuar faturat me rastin e furnizimit të mallrave nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatë), si p.sh. pajisjet për pagesat e parkimit, etj.

**Në nenin 22,** përcaktohet procedura e thjeshtuar për biznesin e vogël që lëshojnë faturadhe të cilat janë subjekt i TVSH-së, sepse ushtrojnë veprimtari ekonomike në përputhje me ligjin për TVSH-në, por nuk i nënshtrohen TVSH-së. Keshilli i Ministrave do të përcaktojë me vendim kategoritë e bizneseve të vogla të cilat do të aplikojnë procedurën e thjeshtuar.

**Në nenin 23,** përcaktohet detyrimi për të printuar faturën në letër, në rastin e pagesave me para në dorë, pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit.

**Në nenin 24,** përcaktohet detyrimi për të lëshuar dhe marrë faturën elektronike në të gjitha transaksionet pa para në dorë ndërmjet dy tatimpaguesve (transaksionet B2B). Kjo faturë elektronike, ose e-Faturë, duhet të jetë në përputhje me standardin e BE-së të përshkruar për e-Faturat në procedurat e prokurimit publik.

Standardit evropian për lëshimin e faturave elektronike është i përshtatshëm për përdorim në transaksionet ndërmjet bizneseve, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për përdorim në fushën e prokurimit publik.

**Në nenin 25,** përcaktohet detyrimi për aplikimin e detyrueshëm të e-Faturës në transaksionet me organet publike, si nga ana e shitësit për lëshuar-Faturë, ashtu edhe nga ana e enteve publike, për të pranuar e-Faturën.

**Në nenin 26,** përcaktohen komponentët e teknologjisë së IT-së që mundësojnë shkëmbimin e e-Faturave, nën përgjegjësinë e AKSHI-t.

**Në nenin 27,** përcaktohen lehtësirat dhe thjeshtësimi i përmbushjes së detyrimeve, sipas këtij ligji, për subjektet që lëshojnë numër të vogël të faturave, të cilët kryesisht janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe tatimpaguesit që nuk janë subjekt i TVSH-së (p.sh. shoqatat jofitimprurëse, personat fizikë, etj)

**Në nenin 28,** përcaktohet përdorimi i standardin evropian për faturën elektronike. Standardi evropian është miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN), më 28.06.2017, EN 16931-1: 2017, Fatura Elektronike - Pjesa 1: Modeli semantik i elementeve bazë i të dhënave të faturës elektronike dhe listat e sintaksës CEN/TS 16931-2:2017, Fatura Elektronike - Pjesa 2: Listat e sintaksës në përputhje me EN 16931-1, sipas sistemit të klasifikimit CEN, të cilin, në përputhje me Direktivën e Këshillit 2014/55/KE, e ka shqyrtuar Komisioni Evropian dhe,

pas testeve të kryera, ka botuar referencën për këtë standard (Vendimi e Komisionit 2017/1870), më 16.10.2017. Publikimi i referencës së standardit evropian për faturën elektronike dhe listat e sintaksës, në përputhje me Direktivën e Parlamentit 2014/55/BE dhe të Këshillit (OJ L 266, 17.10.2017).

Në këtë nen përcaktohet gjithashtu edhe detyrimi për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, në përputhje me ligjin dhe dispozitat përkatëse të Direktivës për TVSH-në 2006/112/KE të cilat transpozohen në rendin juridik të Republikës së Shqipërisë.

**Në nenin 29**, përcaktohet procedura në rast të ndërprerjes së lidhjes së internetit dhe kur një tatimpagues nuk mund të vendos një lidhje me Administratën Tatimore dhe të fiskalizojë faturat.

**Në nenin 30**, përcaktohet procedura në rast të ndërprerjes së punës së pajisjeve fiskale (p.sh. për shkak të defektit, vjedhjes, ndërprerjes së energjisë, etj.). Në këtë rast, faturat nuk mund të përpilohen në pajisjen elektronike, dhe me qëllim të parandalimit të ndërprerjes së veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi do të lëshojë faturat me dorë duke përdorur dëftesat (bllokun e faturave), i cili duhet të vërtetohet nga Administrata Tatimore.

**Në nenin 31**, nëse ndodh që në zona të caktuara, vendbanime, vende ose rrugë nuk është e mundur të vendosen lidhje interneti, ky nen përcakton që faturat duhet të lëshohen duke përdorur pajisjet fiskale, faturat duhet të lëshohen me të gjitha të dhënat e kërkuara përveç NIVF-së.

**Në nenin 32**, përcaktohet detyrimi i fiskalizimit e faturave korrigjuese, në mënyrë që Administrata Tatimore të ketë një pasqyrë mbi të gjitha faturat e lëshuara dhe të korrigjuese. Në bazë të këtyre të dhënave, Administrata Tatimore mund të kryejë kontrole të caktuara dhe të përcaktojë nivelin e riskut të tatimpaguesve të caktuar (korrigjimi i shpeshtë i faturave mund të jetë një tregues që tatimpaguesi qëllimisht manipulon të dhënat, përfshirë edhe numrin e madh të faturave të korrigjuara në të njëjtën kohë, p.sh. në fund të ditës së punës).

**Në nenin 33**, detyrimi për çdo tatimpagues që të afishojë në mjediset e tij të biznesit, në një vend të dukshëm njoftimin që duhet të lëshojë faturë dhe detyrimin e blerësit që të marrë dhe ruaj faturën. Kështu, çdo blerës do të jetë i informuar se shitësi është i detyruar të lëshojë faturë dhe se blerësi është i detyruar ta marrë faturën dhe ta mbajë atë derisa të largohet nga mjedisi i biznesit. Në këtë mënyrë edhe ndikohet në mënyrë psikologjike që vetë blerësit të kërkojnë çdo herë faturën.

**Në nenin 34**, përcaktohet detyrimi për blerësit për të kërkuar faturën nga shitësi pas çdo blerje, në rast të pagesës me para në dorë, si dhe ta ruajë faturën derisa të largohet nga vendndodhja e biznesit.

**Në nenin 35**, përcaktohet mundësia e blerësit për kontroll të faturës menjëherë në momentin e lëshimit nga shitësi dhe për të vërtetuar nëse fatura është regjistruar në Administratën Tatimore, nëpërmjet skanimit të kodit QR në faturë. Pas skanimit të faturës, do të hapet një faqe interneti e veçantë e cila paraqet të gjitha të dhënat e faturës së fiskalizuar ose do të marrin një mesazh se fatura nuk është e regjistruar në Administratën Tatimore. Blerësi pastaj mund të denoncojë tek organet tatimore sipas mënyrës që do të përcaktohet me udhëzim (p.sh. duke dërguar një imazh ose duke skanuar faturën në qendrën e kontaktit të Administratës Tatimore ose duke dorëzuar faturën drejtpërdrejt në Administratën Tatimore).

Në **nenet 36**, përcaktohet detyrimi për mbajtjen dhe ruajtjen e faturave, siç parashikohet nga ligji për TVSH-në, i cili është përafëruar me Direktivën për TVSH-në.

Në **nenin 37**, përcaktohet që secili tatimpagues depoziton në llogarinë e tij bankare paratë që ka mbledhur gjatë asaj dite në para në dorë, me përjashtim të një shume të caktuar të cilën mund ta ketë në dispozicion si depozitë fillestare për ditën e ardhshme të punës.

Në **nenin 38**, përcaktohet maksimumi i parave në dorë që mund të mbajë në arkë çdo tatimpagues, në varësi të madhësisë së tatimpaguesit.

Përveç kësaj, në pikën 6 përcaktohet detyrimi që duhet përmbushur çdo tatimpagues në fillim të çdo dite pune ose përpara lëshimit të faturës, i cili ka të bëjë me njoftimin e Administratës Tatimore për shumën e parave në dorë në arkë, në të njëjtën mënyrë siç kryen procedurën e fiskalizimit të faturës.

Në **nenin 39**, përcaktohet regjistrimi i pagesave të e-Faturave në dy mënyra:

- si detyrim ndaj bankave dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë,
- si detyrim mujor për tatimpaguesit (shitësit), që të regjistrojnë pagesat e pranuar për e-Fatura e lëshuara në llogarinë e tyre në sistemin “self-care”.

Në **nenin 40 deri 43** përcaktohet detyrimi për të lëshuar faturën shoqëruese, një lloj dokumenti që shoqëron mallrat gjatë transportit dhe shërben si dëshmi e pronësisë mbi mallrat. Për faturën shoqëruese zbatohen në mënyrë të përkatese edhe dispozitat tjera të këtij ligji, në veçanti: detyrimi për të regjistruar vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, operatorin dhe ofruesin e zgjidhjes softuerike, pajisjen me certifikate (e cila mund të jetë e njëjtë me atë të faturimit), instalimin e një pajisjeje elektronike për përpilimin dhe shtypjen e një fature shoqëruese në pikën e daljes, zbatimin e procedurës së fiskalizimit përpara lëshimit ose dërgimit të të dhënave në kohë reale nëpërmjet internetit në Administratën Tatimore, shtypjen, ruajtjen, etj.

Në **nenin 41**, përcaktohet përmbajtja e faturës shoqëruese.

Në **nenin 42**, përcaktohet procedura e fiskalizimit e faturës shoqëruese.

Në **nenin 43**, përcaktohet detyrimin i shtypjes dhe ruajtjes së faturës shoqëruese.

Në **nenin 44**, përcaktohet mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji, e cila do të kryhet në përputhje me ligjin nr. 9920/2008, për procedurat tatimore.

Në **nenin 45**, përcaktohen dispozita për kundërvajtje të cilat përmbajnë gjokat në përputhje me ligjin nr. 9920 për procedurat tatimore.

Në **nenin 46**, përcaktohen dispozitat në lidhje me detyrimin për të mbrojtur informacionin e mbledhur në përputhje me ligjin e veçantë, si dhe qëllimi i përdorimit të të dhënave.

Në **nenin 47**, përcaktohen dispozita kalimtare për tatimpaguesit e regjistruar të rinj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilët do të kërkohej të instalonin kasën fiskale për lëshimin e kuponave fiskale dhe pas disa muajsh do të duhej t'i zëvendësonin ato me pajisje dhe zgjidhje softuerike sipas këtij ligji, që do të paraqiste kosto të dyfishtë në një kohë shumë të shkurtër.

Në **nenin 48**, Në këtë nen përcaktohen detyrat e Këshillit të Ministrave për të miratuar një vendim për zbatimin e këtij ligji, si dhe të Ministrit të Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i

AKSHI dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për të nxjerr udhëzimet për zbatimin e këtij ligji, dhe në veçanti specifikimet teknike.

Në nenin 49, përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit brenda 15 ditëve nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare dhe zbatimi i tij në 3 faza:

- fiskalizimi i faturave për pagesë me para në dorë dhe pa para në dorë, si dhe fatura shoqëruese, nga data 1.1.2020.
- e-Fatura e detyrueshme në transaksionet me organet publike nga data 1.1.2021.
- e-Fatura e detyrueshme në transaksionet biznes me biznes dhe regjistrat e pagesave të e-Faturave nga data 1.7.2021.

Në lidhje me futjen e detyrimit për të lëshuar e-Faturë për pagesat pa para në dorë dhenë transaksionet me organet publike, është e nevojshme që zbatimit të kryhet në faza, duke i dhënë përparësi e-Faturës në transaksionet me organet publike, në mënyrë që lëshuesit dhe pranuesit e e-Faturave, si dhe AKSHI, të përshtatin infrastrukturën e tyre të informacionit me sistemin e ri për lëshimin e faturave, dhe për të zbatuar me sukses standardin evropian dhe rregullave tjera të përdorimit të e-Faturës.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.**

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe AKSHI për zbatimin e këtij projektligji.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT.**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) duke perfituar nga asistencë e posaçme për këtë projekt.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projektligj synon të sjellë në një nivel bashkëkohor procedurën e monitorimit të transaksioneve të të gjithë tatimpaguesve në vend me qëllim rritjen e mirëadministrimit tatimor në mbledhjen e detyrimeve tatimore.